

POP 5Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Zjarr në një fshat të Pukës, shmanget rreziku për banesat! Digjen 5 dynym sipërfaqe dhe pemë frutore (VIDEO)
- 2

Më 12 gusht hidhni sytë nga qielli, eklipsi i Diellit do të jetë i dukshëm pjesërisht
- 3

Katër vatra zjarri në kurorën e Tiranës, Taulant Balla: Nuk janë nga Zoti, por nga robil! Zjarrvënia dënohet deri në 15 vite burg!
- 4

Luis Figo sulmon ashpër Infantinon: Mashtrues i utët, duhet të largohet sa më shpejt nga FIFA
- 5

Infantino pranon gabimet dhe kërkon falje, kreu i FIFA-s refuzon të dorëhiqet: Procesi duhet të menaxhohej ndryshe, s'do tolerojmë më sulme

Kronikë

Lezhë/ Plumba makinës së kushëririt në Patok, 3 të arrestuar, 1 në kërkim! Të afërmit nga Laçi fshehin armën, policia nis hetimin (EMRAT+VIDEO)

Sipas policisë, në pranga ranë babë e bir, Gjon dhe Arben Laska 67 dhe 40 vjeç dhe kushëriri i tyre, Elvis Laska 28 vjeç, të gjithë banues në Laç. Ndërkohë djali tjetër i 67-vjeçarit, Vlash Laska u shpall në kërkim.

REPORT TVLezhë/ Familjarët qëllojnë me armë makinën e kushëririt në Kurbin, 3

Report TV



Watch on

[Sh] Redaksia12 Gusht, 10:53 | Përditësimi: 12 Gusht, 12:17

f SharePostWhatsApp



Një 38-vjeçar kallëzoi në polici, se mesditën e djeshme, teksa lëvizte me makinë në rrugën e Patokut, u qëllua me **armë zjarri**. Nga hetimi i nisur, policia zbuloi se të dyshuarit janë të afërm të tij, 3 prej të cilëve u arrestuan, dhe një i katërt u shpall në kërkim

Sipas policisë, në pranga ranë babë e bir, Gjon dhe Arben Laska 67 dhe 40 vjeç dhe kushëriri i tyre, **Elvis Laska** 28 vjeç, të gjithë banues në Laç. Ndërkohë djali tjetër i 67-vjeçarit, Vlash Laska u shpall në kërkim.

Në një njoftim zyrtar, blutë thonë se ata janë konfliktuar verbalisht me kushëririn e tyre 38-vjeçar për motive pronësie, dhe kanë qëlluar me armë në drejtim të makinës me të cilën ai lëvizte, fatmirësisht pa e plagosur.



[Sh]LEXO EDHE:**Kurbin/ Banorët e Gjormit në protestë për rrugën dhe ujin: Nuk është investuar që prej 35 vitesh (VIDEO)**

Nën frikën e plumbave, gjatë largimit, 38-vjeçari është aksidentuar me një tjetër automjet, por vetëm me dëme materiale.

Arma ende nuk është gjetur.

Njoftimi i policisë:

Qëlluan me armë zjarri, në drejtim të automjetit me të cilin lëvizte kushëriri i tyre, për motive të dobëta, arrestohen 3 shtetas dhe shpallet në kërkim 1 (familjarë të njëri-tjetrit).

Si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore dhe policore, të kryera nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Kundër Personit, menjëherë pas kallëzimit të shtetasit P. L., 38 vjeç, se mesditën e djeshme, në drejtim të automjetit me të cilin lëvizte në rrugën e Patokut, ishte qëlluar me armë zjarri, u mundësuan lokalizimi dhe ndalimi i shtetasve të përfshirë në këtë rast, konkretisht Gj. L., 67 vjeç dhe Gj.(A.) L., 40 vjeç, babë e bir, dhe E. L., 28 vjeç, kushëri i tyre, të gjithë banues në Laç.

Gjithashtu, u shpall në kërkim djali tjetër i shtetasit Gj. L., shtetasi V. Gj.(L.), 35 vjeç, banues në Laç.

Nga veprimet hetimore ka rezultuar se këta shtetas, pas një konflikti verbal, për motive të dobëta, me kushëririn e tyre, shtetasin P. L., kanë qëlluar me armë zjarri, në drejtim të automjetit me të cilin lëvizte ai. Nga ky rast, nuk pati shtetas të dëmtuar.

Shtetasi P. L., gjatë largimit nga vendngjarja, ka përplasur me automjetin që drejtonte, një automjet, me pasojë vetëm dëme materiale. Automjeti i 38-vjeçarit u sekuestrua me cilësinë e provës materiale.

Punohet për kapjen e shtetasit V. Gj.(L.), për gjetjen e armës së zjarrit, si dhe në drejtimin e Prokurorisë, për individualizimin e përgjegjësisë penale të secilit prej shtetasve të përfshirë në këtë rast.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Lezhës, për veprime të mëtejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

P.J/Shqiptarja.com

TAG: elvis laska vlash gjonigjon alfred laskagjon Laskaarrestimarme zjarriLezheLaçi

Sa e vlerësoni këtë artikull?★★★★★

★ LAJMET MË TË VLERËSUARA >

Komente

Komento

Ndalohet reptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:**A mendoni se Shqipëria është e përgatitur për sezonin e zjarreve?**

9 Gusht, 17:40

PoJoI/e dyzuar

Lajme të tjera



Ekstradohet nga Shqipëria në Kosovë për vrasje i kërkuari ndërkombëtar, ishte i dënuar me 11 vite e 6 muaj burg (EMRI)

11 Gusht, 15:53



Lëvizte me pistoletë në Durrës, arrestohet suedezi! Në pranga edhe një 24-vjeçar, tentoi të vidhte një kasafortë në një banesë (VIDEO)

11 Gusht, 11:17




Përdorte profile false për të kërcënuar e përndjekur duke kërkuar para, pranga 24-vjeçarit në Tiranë (EMRI+VIDEO)

11 Gusht, 10:08




AMP bën bilancin për muajin korrik: 11 persona të arrestuar, mes tyre 8 punonjës Policie! Referuam në Prokurori 54 efektivë

10 Gusht, 17:13



I dënuar me 14 vite burg në Itali për trafik droge, arrestohet në Durrës Kastriot Dyrmishi (VIDEO)

10 Gusht, 14:39




Ishte duke ecur, 28-vjeçari qëllohet me armë zjarri në Laç! Shpëton mrekullisht (EMRI)

10 Gusht, 14:31




Lezhë/ Shpërthim me tritol në murin rrethues të një banese në Shënkoll! Nisin hetimet

10 Gusht, 13:42




Sezoni turistik, e hëna nis trafik të rënduar në Lezhë e Shëngjin (VIDEO)

10 Gusht, 11:44



Trafik i rënduar në Vlorë e Lezhë, radhë automjetesh që në nisje të javës! 'Transballkanikja' dhe 'Lungomarja' akset më të ngarkuara (VIDEO)

10 Gusht, 10:38



Policia Kufitare shpëton dy persona nga mbytja në Velipojë

9 Gusht, 11:29



Aksidenti i trefishtë në aksin Lezhë-Laç, një person i lënduar (VIDEO)

8 Gusht, 08:12



Do të bënin atentat dhe u kapën me armët në duar, gjykata lë në burg 2 prej autorëve në Sarandë! Arrest shtëpie për 3 të tjerët

7 Gusht, 18:08

Lajmi i fundit



Zjarr në një fshat të Pukës, shmanget rreziku për banesat! Digjen 5 dynym sipërfaqe dhe pemë frutore (VIDEO)

12 Gusht, 19:32

[Sh].com

Lajmi i fundit



Zjarr në një fshat të Pukës, shmanget rreziku për banesat! Digjen 5 dynym sipërfaqe dhe pemë frutore (VIDEO)

12 Gusht, 19:32